

## Njoftim

Në bazë të Nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” i ndryshuar, Ministria e Energjisë dhe Industrisë njofton si më poshtë:

Bashkimi i përkohshëm i Shoqërive “AGE” ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY SH.A. dhe “A.E. Distribution” Sh.P.K., kanë shprehur interesin dhe kanë paraqitur pranë Ministrisë, aplikimin për ndërtimin e një parku fotovoltaik për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme, me kapacitet 1.750 MW, në zonën “Topojë”, Bashkia Fier.

### Përshkrim i Projektit:

Shoqëritë “AGE Group” ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY SH.A. dhe “A.E. Distribution” Sh.P.K. kanë aplikuar për pajisjen me autorizim paraprak në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” i ndryshuar, për ndërtimin e një parku fotovoltaik në Zonën Topojë, Bashkia Fier me një sipërfaqe totale të projektit 2.34 ha ku kapaciteti i instaluar do të jetë 1.750 MW me një vlerë investimi rreth 2 milion Euro

Aplikimi i detajuar për publikun e interesuar, të Bashkimit të përkohshëm të Shoqërive “AGE” ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY SH.A. dhe “A.E. Distribution” Sh.P.K., mund të gjendet pranë ambienteve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, 1001 Tiranë, Faqja web: [www.energjia.gov.al](http://www.energjia.gov.al)

Afatin për dërgimin e objeksioneve ose komenteve në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë është 15 dite, duke nisur nga data e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare: [www.energjia.gov.al](http://www.energjia.gov.al)